



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Për:	Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës Z. Glauk Konjufca , Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
Nga:	Besnik Tahiri , kryetar i Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në emër të deputetëve nënshkrues
Lënda:	Mocion Përmbajtjesor
Data:	22 mars 2024

Në mbështetje të nenit 65, paragrafit 1 dhe 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 58 të Rregullores së Kuvendit, deputetët nënshkrues parashtrojnë këtë mocion përmbajtjesor:

Cështia: *Tre vjet qeverisje*

A r s y e t i m

Republika e Kosovës tani më ka hyrë në muajt e fundit të mandatit katërvjeçar të Qeverisjes së Lëvizjes Vetëvendosje, me z. Albin Kurti, Kryeministër.

Në fillim të mandatit, më 22 mars 2021, Kryeministri Kurti paraqiti ekspozenë, një përmbledhje e deklaratave të zbrazëta, megjithëse kishte hequr dorë nga parimet kryesore si opozitar, përsëri ai vazhdoi të hedhë mjegull. Asokohe, Kurti renditi si prioritet drejtësinë, shëndetësinë, arsimin dhe ekonominë. Fjalimi, apo e ashtuquajtura ekspozë e tij, ishte një përmbajtje e thatë, pa asnjë referencë në evidencë, në projeksione, në plane, apo përlllogaritje. I papërvojë në qeverisje, pa asnjë përgatitje në punët e shtetit, ashtu sikurse ishte edhe ekipi i tij qeveritar, qytetarëve të cilët e votuan, ai ua servoi një listë dëshirash. Edhe aty ku ishte paksa specifik, sot shohim se ka dështuar katërçipërisht.

Në mungesë të plotë të vizionit, e programit politik, Kurti kishte listuar në numra prioritetet, e që, as si ndoqi si kronologji, e as si qëllim. Dialogu nga prioriteti i shtatë, u kthye në prioritetin e vetëm. Të gjitha prioritetet u shkrinë në një, atë të dialogimit, si formë dhe mjet i vetëm i ushqimit i politikave elektorale dhe i popullzimit. U deshën dy muaj, deri në maj të vitit 2021, për të paraqitur programin e shkruar. Ngjashëm me ekspozenë edhe ky dokument ishte i thatë dhe pa evidencë. Në realitetin shoqëror, punësimet politike, familjare, favorizimet, tendenca e kontrollit mbi administratë, gjuha degraduese ndaj mediave, përplasjet me sindikatat, ka shënuar nivelet më të ulëta. Si rrjedhojë e humbjes së energjive të shpenzuara në popullizëm, duke harruar nevojën për reforma të mirëfillta.

Le të ndalemi te prioritetet veç e veç.

Punësimi, ishte kryefjala, por që në fakt nuk ndodhi në Kosovë, në vend të kësaj, u zëvendësua me shifrat alarmante të migrimit. Kriza e migrimit masiv që ka vazhduar edhe në vitin 2023, e me rrezik që të marrë përmasa edhe më të mëdha. Tashmë, ky migrim po rrezikon tërë zinxhirin ekonomik, duke ulur konsumin, por edhe shtyrë bizneset drejt kolapsit. Sipas Agjencisë të Statistikave, për vitin 2023, shifrat janë alarmante në lidhje me shkallën e joaktivitetit në tregun e punës, me mbi 700 mijë qytetarë joaktivë. Pa asnjë politikë të fuqizimit gjinor në tregun e punës, për femrat përqindja është dy herë më e lartë se sa te meshkujt. Kjo është akoma më alarmante sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës. Në një ekonomi me dhjetëra mijëra të papunë dhe me qindra mijëra joaktivë, raportohen trende minimale të rritjes së punësimit, dhe uljes së papunësisë. Ato sillen rreth 20 mijë, shifër kjo e cila për një vend ku do të kishte zhvillim, do të realizohej nga 1 apo 2 investime të huaja strategjike, që për këtë qeveri nuk shihen askund në horizont. Se sa të mjera janë arritjet e kësaj qeverie në kuptimin e zhvillimeve në tregun e punës, e konfirmon edhe fakti që nivelet e shifrave të përfituesve të ndihmës sociale, mbesin pothuajse të pandryshuara. Sidoqoftë, duhet theksuar se edhe ato pak përmirësime kozmetike në tregun e punës, me të cilat kjo qeveri ka synuar t'i maksimizojë për efekte PR-it, nuk janë asgjë më shumë se sa rrjedhoja të migrimit të dhjetëra mijëra punëmarrësve të moshave të reja për në Gjermani. Me fjalë të tjera, kur të rinjtë e punësuar dhe të papunësuar migrojnë, me automatizëm kemi edhe vende të lira pune, të cilat kjo qeveri i keqraporton si rritje e punësimit.

Drejtësia, qoftë si realitet shoqëror, apo edhe si shtyllë shtetërore, karakterizohet me dështim të madh. Në rrafshin e reformave në sistemin e drejtësisë, tashmë është e konfirmuar në disa raste për shkeljet, që në esencë kishin kapjen e sistemit. Në premtimet e ditëve të para të kësaj qeverie, përmes ekspozesë dhe programit të paraqitur nga kryeministri, premtohej se përmes digjitalizimit dhe masave tjera do të ketë reformim të sistemit të drejtësisë. Sidoqoftë, digjitalizimi në mungesë të shoqërimit të masave që prekin burimet njerëzore dhe kapaciteteve administrative, nuk mund të ketë drejtësi efikase. Në fakt për këtë kohë të kësaj qeverie në pushtet, ne pamë që në emër të reformës është synuar kapja e sistemit të drejtësisë. Format e kësaj tentim kapjeje kanë qenë të shumta, por le ta kujtojmë këtu Vendimin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila me 13 tetor 2023, aprovoi në tërësi nismën e Shoqatës së Prokurorëve, duke rrëzuar si të kundërligjshëm vendimin e Qeverisë për uljen e pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve, më 22 nëntor 2022, madje këtë qeveria e kishte bërë në kundërshtim me vendimin e 12 shkurtit 2020 të Gjykatës. Pra, reforma sipas Kurtit është goditja në pavarësinë e gjyqtarëve, duke i goditur ata në të drejtën e tyre ligjore dhe në mirëqenien individuale dhe familjare. Qysh në fillim të mandatit, në gusht të vitit 2021, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i kishte reaguar qeverisë për deklaratat të cilat cenonin pavarësinë e gjyqësorit. Gjuha ndaj sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, prokurorëve dhe gjyqtarëve, nuk është ndalur asnjëherë nga kjo qeveri, pavarësisht se në program zotohej se do të angazhohet për parimin e ndarjes së pushteteve, si vlerë themelore e rendit demokratik dhe shtetit të së drejtës. Kryeministri, vartësit e tij në parti e qeveri, nga foltorja, flasin lirshëm për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit si të ishte i afërmi i tyre, e jo për një sistem të pavarur, ku

demokracia i sanksion të flasin për këtë çështje. Raporti i Transparency International, thekson se “Qeveria duhet ta përmirësojë ende transparencën dhe të përmbahet nga çdo ndërhyrje në sistemin e drejtësisë”. Raporti i Komisionit Evropian, ka konstatuar se Kosova është ende në fazën fillestare të zhvillimit të një sistemi juridik funksional. Impulsin për kapje të institucioneve, për përqendrim të pushtetit, e konfirmojnë edhe numri enorm i projektligjeve të rrëzuara nga Gjykata Kushtetuese. Qeveria prinë në kundër kushtetutshmëri, me 10 raste, pothuaj dyfishin e rasteve në krahasim me qeveritë e kaluara.

Ekonomia dhe Investimet Publike – që në fillim, duhet shtruar një pyete, çka ka ndodhur me Bankën Zhvillimore, si duket as këtë e as për funksionimin e ekonomisë, nuk e kanë pasur të qartë as për çfarë e kishin fjalën. Në rrafshin ekonomik, Kosova ka shënuar krizën më të madhe, në njërën anë inflacioni, e në anën tjetër mosveprimi, ka shtyrë që të shënohen nivelet më të larta të inflacionit, duke arritur deri në 19 % sipas Bankës Botërore, e nga vlerësimi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës 14,2 %. Si rezultat i rritjes së çmimeve në shportën e konsumit, në mesatare prej 15% e disa produkte bazike, si lëndët djegëse, deri në 40% në njërën anë, e rritjes së papërbalueshme të çmimit të energjisë mbi 100% për tarifën e larta në anën tjetër, ka varfëruar gjepin e çdo familjeje. Si pasojë e kësaj, kreditë për konsum kanë shënuar rritjen prej 0.22 për qind, e ato investuese rënie, 0.18 %. Për tre vjet, kjo Qeveri nuk ka arritur të ekzekutojë 1 miliard e 100 e 22 milionë euro në investime kapitale, që nënkupton se për këtë shumë kemi më pak rrugë, më pak shkolla dhe gjithçka që ka qenë në platformën ‘Krejt dhe drejt’ ishte një mashtrim i madh.

Në vitin 2021 nuk janë realizuar 254 milionë euro, në vitin 2022, 533 milionë euro dhe në vitin 2023, 338 milionë euro. Tashmë po dëshmohet, se mosshpenzimi i investimeve kapitale, ishte shtyrë nga nevoja për negociimet në tenderët njëburimorë. E në shumë raste, në aneks kontratat. U dhanë 209 milionë euro, në 781 kontrata të negociueshme, në negociime, me një, apo disa kompani. Duke shmangur krejtësisht konkurrencën, përjashtuar qindra operatorë e rrezikuar kontratat me çmimet më të larta. Tutje, sipas Raportit të Komisionit Evropian, përtej ndonjë ndryshimi eventual ekonomik, mungesa e diversifikimit ekonomik, varësia e lartë nga importi, dhe kapacitetet e paqëndrueshme të furnizimit me energji, e mbajnë Kosovën në një situatë cënueshmërie, para tronditjeve eventuale ekonomike. Kosova po përjeton një tronditje ekonomike, si shkak i “shembjes” së bizneseve. Me qindra biznese të vogla gjithandej Kosovës, duke përfshirë dyqane, biznese të vogla të shitjes, kafiteri, restorante rrezikojnë të mbylljen për shkak të mungesës së konsumit. Fuqia blerëse ka rënë nga 15%, deri në 50%. Me mbylljen e bizneseve do të shkojmë drejt rritjes së papunësisë në Kosovë, që ndikon në rritjen e varfërisë dhe në uljen e nivelit të jetesës për qytetarët.

Përtej dështimeve në tri prioritetet kryesore, dështimet vijojnë edhe në:

Politikën e Jashtme dhe Dialogu - Kosova për herë të parë ballafaqohet me masa dhe me sanksione nga Bashkimi Evropian, ndërsa raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në nivelin më të ulët. Nuk kemi asnjë anëtarësim në organizatat e rëndësishme ndërkombëtare dhe po ashtu, nuk kemi as njohje dhe as avancime të tjera në këtë fushë, tërheqja e ambasadorëve pa asnjë shpjegim dhe lënia bosh e vendit të tyre për muaj të tërë. Në maj të vitit 2023, si rezultat i papërgjegjësisë së kryeministrit

Kurti, SHBA-të anuluan pjesëmarrjen e Kosovës në “Defender Europe“, dhe sikur kjo të mos mjaftonte, me kalimin e kohës u përmend edhe fakti që SHBA-të nuk ka ndonjë entuziazëm që të asistojnë Kosovën në përpjekjet e saj për të zgjeruar njohje më të gjerë ndërkombëtare, apo për ta përkrahur në procesin e anëtarësimit në NATO dhe BE. Është bërë e paqartë, se a po i nxitë kryeministri Kurti krizat e brendshme për të mbuluar skandalet diplomatike, apo anasjelltas. Qeveria Kurti prodhon kriza në vend se të afirmoj vendin. Dëmtimi i rëndë i marrëdhënieve me aleatët, të cilët përmes NATO-s, sigurojnë kufijtë e Kosovës dhe mbrojtjen nga Serbia, janë rrezik afatgjatë për Kosovë. Në fushën e marrëdhënieve dypalëshe diplomatike, Kosova me përjashtim të Shqipërisë, nuk ka asnjë komunikim dhe marrëveshje të nivelit strategjik. Madje, edhe komunikimi me Shqipërinë është shoqëruar me tone të papërshtatshme moskoordinimi. Shërbimi diplomatik i Kosovës është heshtur nga qeveria, dhe si i tillë nuk ka asnjë instruksion se si t’i afirmojë interesat ekonomike dhe investimeve të vendit, si të argumentoj në lidhje me pozicionet e Kosovës në dialog dhe në lidhje me nevojën për njohje reciproke. Paligjshmëria në këtë sektor karakterizohet zyrtarë që nga pozitat e ulëta menaxheriale, ish- zyrtarë të Ministrisë së Diasporës, janë katapultuar si ushtrues detyre në pozita menaxheriale, pa asnjë ditë përvojë diplomatike. Premtoi se nuk do ta vazhdojë dialogun me Serbinë pa zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, dhe se përmes dialogut do të kërkojë 3 miliard euro të pensioneve të vjedhura, kthimin e 400 milionë eurove të keqpërdorimit të energjisë elektrike në veri, sot flet për dinarin, dhe edhe me një rast terrorizmi shtetëror si Banjaska, nuk ka asnjë proces kundër Serbisë.

Kontrolli mbi administratën shtetërore, e presioni mbi mediat – Lufta ndaj institucioneve të pavarura, ka vazhduar edhe me presionin politik brenda, por edhe tendencën e normimit ligjor të kontrollit, duke krijuar pasiguri juridike dhe presion politik tek zyrtarët e administratës shtetërore. Ngjashëm me këtë, një shpërfytyrim i rrallë, i gjuhës së linçimit publik është bartur nga përfaqësuesit institucionalë në ballafaqime me mediat.

Qeveria e Kosovës e ka në miratim Ligjin për Zyrtarët Publikë në mbledhjen elektronike. Në mungesë, të rritjes serioze të pagave në sektorin publik, dështimeve dhe përjashtimit nga paga mesatare, barra më e rëndë e kësaj krize po e shtynë shtresën e ‘mesme’ tek varfëria, ndërkaq të varfrit në kufijtë e ekzistencës. Të gjitha përpjekjet, e nismat ligjore përfytyrojnë tendencën për kontroll, por edhe përjashtime masive nga administrata. Në dy raste, Ligji për zyrtarët publikë, ka dëshmuar se qeveria, dëshiron që instrumentin e presionit ta bëjë normë ligjore, e përmes kësaj në njërën anë të mbajë në kontroll partiak administratën, e në anën tjetër të lehtësojë largimet, e të mundësojë zëvendësimet me ushtrues detyre nga eksponentët. Ky Ligj u miratua pa asnjë ditë të konsultimit publik, pa përfshirjen e asnjë rekomandimi të vetë zyrtarëve publikë dhe pa trajtimin e sugjerimeve të BE-së. Me këtë ligj po kapet politikisht administrata e shtetit. Mungesa e konsultimit me palët e afektuara, që janë zyrtarët publikë. Kjo e bënë projektligjin pa legjitimitetin e nevojshëm; Projektligji shkon kundër aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, duke paraparë që nëpunësit që janë emëruar në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, të privohen nga e drejta ligjore e fituar me ligjin që ka qenë në fuqi kur janë emëruar. Projektligji i ri, duke i dhënë vetes efekt retroaktiv, e cenon të drejtën ligjore të fituar të kësaj kategorie. Krejt kjo në

kundërshtim flagrant me parimet e SIGMA-s dhe BE-së, si një detyrim që Kosova ka marrë me MSA-në, që RAP ta bëjë në koordinim me BE-në, të cilën gjë nuk po e bënë; Ky projektligj shkel të drejtat e njeriut, pasi që bazohet në supozimin e paargumentuar se nëpunësit civilë nuk vlejné dhe se ata duhet të largohen masivisht nga puna, për të sjellë në ato pozita persona të dëgjueshëm për politikën në pushtet. Thjeshtë, është një hap në kapjen e administratës shtetërore, krahas edhe hapave që kjo qeveri ka ndërmarrë në kapjen e shtetit; Largim nga fushëveprimi i Ligjit për Zyrtarët Publikë, në mënyrë të qëllimshme dhe pa bazë (kjo vlen edhe për nëpunësit civilë me status të veçantë); Zgjatja e afatit deri në dy vjet për ushtrues detyre, tendencë e qartë për ligjësimin e këtij fenomeni të rrezikshëm; Heqja e pragut minimal, që së paku dy kandidatë duhet t`i plotësojnë kushtet për nivelin e lartë drejtues është e gabuar dhe me pasoja në zbatimin në praktikë; Vendosja e marrëveshjes për praninë të nëpunësve civilë, të cilët janë tepriçë sipas paragrafit 3 të nenit 67 është shumë e rrezikshme dhe me qëllim mund të vijë në situatat që institucionet mos t`i pranojnë nëpunësit dhe të njëjtët të largohen nga shërbimi civil (shih paragrafin 5 të nenit 67); Pezullim i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë; Kthimi i mandatit për nëpunësit civilë aktualë në kategorinë e ulët dhe të mesme në kundërshtim me aktgjykimin, rastet: nr. KO216/22 dhe KO220/22, sipas të cilit mandatet mund të vlejë vetëm për nëpunësit e ri të cilët krijojnë marrëdhënie pune pas hyrjes në fuqi të ligjit. Reforma e administratës dhe sundimi i ligjit janë dy kërkesa të BE-së, pa të cilat nuk hapet asnjë kapitull i negociimit për anëtarësim në BE. Në Raportin e fundit të BE-së, thuhet se, Ligji për Zyrtarët Publikë, nuk pasqyron zotimet e MSA-së, që i ka marrë përsipër Republika e Kosovës.

Shëndetësia dhe Mirëqenia - Premtoi një shëndetësi të mirë dhe jemi në vitin e katërt dhe ende Ligji për Sigurime Shëndetësore nuk është miratuar, as në Qeveri e lere më të vije në Kuvend. Klinika e QKUK-së në tri vitet e fundit ishte pista për eksperimente, me emërimet e shkarkime të personelit mjekësorë, ndërsa, vet Ministria e Shëndetësisë ishte dikaster ku u ndërruan tre herë ministrat, duke u bërë pjesë e këtij dështimi të madh edhe direkt vetë Kryeministri. Tri vite pas, kur po kërkojmë llogari, listat e pritjes janë të pafundme, mungesa e barnave esenciale është bërë normë e kësaj qeverie. Ndërkaq, mirëqenia është ulur, përderisa paga minimale është në trajtim në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se shumica e cila është prezantuar prej 250 eurosh, në fakt ajo pagë ka qenë në sektorin publik. Kjo ka qenë vetëm për ta mbuluar një të vërtetë që ekziston. Kemi kërkuar që paga minimale të jetë 400 euro dhe në të, të përfshihen veteranët e UÇK-së, të cilët janë përjashtuar nga ligji dhe e drejta për jetesë. Kjo platformë politike e majtë ka ardhur me dy premtime të mëdha: të bërjes së sigurimit shëndetësor dhe pensionet. Askush nuk e ka të qartë se pse nuk vjen sigurimi shëndetësor dhe pse nuk është në diskutim. Për tre vjet nuk kanë arritur ta sjellin në Kuvend një ligj për sigurimet shëndetësore. Premtoi sigurim shëndetësor dhe jetësor për policët, dhe jo që ua ofroi, por u bëri pafund lojëra me kërkesat e tyre si dhe me shtesat që i meritojnë. Edhe pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, ku konstatohet shkelje e të drejtave në pensionet kontributdhënëse, qeveria përveç se po e zvarrit procesin, brenda tij nuk shihet vullnet për zgjidhje të drejtë si pasojë, u deshtë që të ketë adresim tek Avokati i Popullit për këto shkelje. Si pjesë e përkrahjes për familjen u premtuan 50 euro në muaj për fëmijë për familjet që fitojnë më pak se 7,000 euro, 100 euro për ato me më pak se 6,000 euro, dhe 150 euro, për familjet me më pak se

5,000 euro. Asnjëra nga këto nuk u zbatua. Në mungesë të reformave serioze në fushën e mirëqenies sociale janë shpërndarë mjete pa kritere dhe pa koncept. Në buxhetin e vitit 2024, ndarja buxhetore për skema pensionale dhe sociale arrin 600 milionë euro. Në krah të kundërt me reformën, qeveria ka shthurur strukturat institucionale, duke e shkrire Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, i është larguar programit qeverisës si dhe ka devijuar në tërësi agjendën legjislative në këtë fushë. Në vend të reformës, rritjes së barazisë e sigurisë sociale, ka ndarë "lëmoshë", praktika këto të këqija për të konsoliduar një sistem të mirëfilltë. Pasojat janë afatgjate, madje indikative për shtytje në migrim. Pasiguria sociale, mungesa e sigurimit shëndetësor si dhe pabarazia janë rritur. Shto këtu edhe se dialogu social ka arritur në pikën më të ulët.

Arsimi – Në fushën e arsimit, nisim me konstatimin me shkeljet Kushtetuese, të ndërhyrjes në reformat komunale. Në atë rast u shpërfaqën krejt qasja e kësaj qeverie ndaj reformave, por edhe tendencave të hapura politike për të ndërhyrë në punët komunale, mbajtur anë partiake. Në mungesë të dialogut me sindikatat, qeveria me gjuhë linçuese, e duke përdorur shpifje, degradoi e poshtëroi gjithë punonjësit e sistemit arsimor. Madje, ishte rast i paprecedent, kur nisën me ndëshkimin e ndaljes së pagave. Në asnjë nivel të arsimit, nuk u panë reforma. U premtua ndërtimi i 200 çerdheve, e në mungesë të rezultateve, po rrisin përqindjet. Asnjë reformë, asnjë progres. Pisa, që përdorej për denigrim të gjithë sistemit arsimor, shënoi rënie, por që nuk u mor asnjë përgjegjësi. Të gjitha institucionet vartëse, u zëvendësuan me njerëz partiak. Asnjë investim serioz, as në cilësi, as në infrastrukturë, e mos të flasim për digjitalizim e teknologji. Premtoi ushqim falas për nxënësit nga klasa e parë deri në të 5-tën, asgjë nga kjo.

Dështimi në fushën e energjisë - Në nisje të mandatit, u ndërpre projekti i gazsjellësit amerikan që do të siguronte investime strategjike dhe të qëndrueshme, duke rritur sigurinë energjetike dhe potencialin për zhvillim. Për më keq, ndërtimi i kapaciteteve të reja, është vendnumërim. U deshën dy vite për të bërë strategjinë e re, e që në esencë nuk shihet asnjë përparim. Si pasojë, miliona euro, ju morën qytetarëve në gjepat, e buxheti duke krijuar skandale si ai shitblerjeve me ndërmjetësimin e Martinit, kontratave të Nagipit, e ai i punësimeve të familjarëve, e militantëve. U dhanë miliona, duke u rritur shpenzimet për energjinë e serbëve në komunat e veriut të Kosovës, e në kurriz të qytetarëve.

Lufta ndaj korrupsionit – edhe pse raporti i progresit vlerëson miratimin e pakos së ligjeve kundër korrupsion, në të vërtetë, kjo qeveri, ato i përdorë si mekanizma mbrojtës në tendencën masive për korrupsion. Edhe Departamenti Amerikan i shtetit, konsideron problem serioz korrupsionin qeveritar. Korruptimi i luftës kundër korrupsionit është një fenomen serioz, i rrezikshëm dhe nuk mund të pretendojë qeveria se po e lufton korrupsionin, kur personat e korruptuar e të lidhur me politikën i ndan prej të tjerëve, siç është rasti i rezervave shtetërore, çështja e energjetikës në KEK, e rasti i ambasadorit në Kroaci, i cili tërheq miliona euro kesh. Krejt lufta ndaj korrupsionit, është përdorur si gjuhë lufte ndaj kundërshtarëve politikë, e në realitet nuk është distancuar, për më tepër ka mbrojtur rastet e skandalet korruptive brenda qeverisë e njerëzve të afërt. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian nënvizon se sektori privat vazhdon cenohet nga sfida strukturore, nga ekonomia e shumëpërhapur

joformale, mbizotërimi i korrupsionit dhe sundimi i dobët i ligjit, që të gjitha këto premtime opozitare dhe qeveritare të kryeministrit Kurti. Përsëri farsë dhe mashtrim.

Mbi arsyet e shënuara dhe nevojës për debat parlamentar për punën trevjeçare të qeverisë, ne, deputetët e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, nënshkruar të këtij mocioni, kërkojmë mbajtjen e seancës së Kuvendit. Presim caktimin e të njëjtës nga Kryesia e Kuvendit. Krahas këtij mocioni përmbajtjesor, propozojmë edhe draftin e Rezolutës, e cila prezantohet për miratim në seancën plenare (pas përpjekjeve për unifikim të grupeve parlamentare për tekstin e saj).

Bashkëngjitur:

- *Nënshkrimet e deputetëve të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, parashtrues të këtij mocioni;*
- *Draft Rezoluta;*



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 65 (1 dhe 9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 (1.5) dhe nenit 58 (mocionet përmbajtjesore), të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më ___/___/2024, me propozimin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, miratoi këtë:

(Draft) R E Z O L U T Ë

Kuvendi i Republikës së Kosovës

1. Të gjithë parametrat e deritashëm, sot në tre vjetorin e kësaj Qeverie, janë dëshmi se janë plotësuar të gjitha kushtet që qeveria ta përmbyllë mandatin e saj me dorëheqje, ose me mocion për shkarkimin e saj, të propozuar nga AAK.
2. Pas dorëheqjes ose shkarkimit të qeverisë, të shpërbëhet Kuvendi i Republikës së Kosovës.